

VENDIM
Nr.1613, datë 10.12.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, ME KOHË TË PLOTË, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME, NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, në Fakultetin e Edukimit, si më poshtë vijon:

- a) Në lëndën “Gjuhë angleze”;
- b) Në lëndën “Gjuhë italiane”.

Në përfundim të këtyre programeve lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP) në mësuesi”, për ciklin e lartë të arsimit bazë.

2. Programi i studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, realizohet me 60 kredite dhe zgjatja normale e tij është një vit.

3. Kuota e pranimeve në këto programe studimi, për vitin akademik 2008-2009, të jetë si më poshtë vijon:

- i) Në lëndën “Gjuhë angleze”, 120;
- ii) Në lëndën “Gjuhë italiane”, 120.

4. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij, në masën jo më pak se 30 për qind, për studentët, që kanë përfunduar, të paktën, ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 për qind, për ata që i kanë përfunduar këto studime pranë tij. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ka të drejtë ta plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar në këtë universitet. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, përcaktuar nga njësitë kryesore të universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, bëhen publike paraprakisht.

5. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas nënndarjes “ii” të shkronjës “a” të pikës 7 të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i dytë i studimeve dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si dhe tarifën e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009”.

6. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbrit, të shurdhët, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentët me aftësi të kufizuara, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë a të plagosur për shkak të detyrës, të ish-të përndjekurve politikë, që fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi, master i nivelit të parë në mësuesi, në institucionet publike të arsimit të lartë, të paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

7. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

8. Studentët e shkëlqyer nuk paguajnë, në çdo program studimi, master i nivelit të parë në mësuesi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

9. Kuotat e pranimeve në këto programe, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, që

mbeten të porealizuara, rishpërndahen, sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

10. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha